



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-368
24.11.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.ynë ark.01-3732/1 datë 29.7.2019, njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit televiziv nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, ark.nr.0306-110/1 datë 18.10.2023 (nr.ynë ark.08-3795/1 datë 18.10.2023), deklaratat (e noterizuara), nr.ynë ark.08-3795/2 datë 17.11.2023 nga drejtuesi i transmetuesit UZP nr.14145/2023, Drejtuesit e Shoqërisë për tregti dhe shërbime KISS&MENADA SHPK Tetovë UZP nr.14146/2023 dhe nga themeluesit/pronarët e SHTSH KISS&MENADA SHPK Tetovë UZP nr.972/2023, UZP nr.14149/2023, UZP nr.14148/2023 të gjitha nga 17.11.2023 dhe konkluzionin me nr.ark.02-4325/11 datë 23.11.2023, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 38-të mbajtur më datë 23.11.2023 solli:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky Aktvendim botohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në uebfaqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, është posedues i lejes për transmetim televiziv PA1 nr.08-542 datë 11.12.2019, me vlefshmëri prej 9 (nëntë) vitesh (nga 19 nëntor 2019 deri më 18 nëntor 2028), për transmetim nëpërmjet operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse të kufizuara, në nivel rajonal në zonën D8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçishtë, Bogovinjë, Brevenicë, Tearce, Jegunovce dhe Zhelinë), shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues në gjuhën maqedonase.

Më datë 18.10.2023 Televizioni SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) dorëzoi njoftim për ndërprerje me transmetim të programit televiziv ark.nr.0306-110/1 datë 18.10.2023 (nr.ynë ark.08-3795/1 datë 18.10.2023), me të cilën e njoftoi Agjencinë se SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë datë 19.11.2023, ndërpreret me transmetim të programit televiziv. Në lidhje me njoftimin e cekur, Agjencia më 16.11.2023, në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin Qendror të RMV-së, ku adresa elektronike është evidentuar në regjistrin e radiodifuzerëve të Agjencisë, në mënyrë elektronike ka njoftuar

transmetuesin në fjalë se në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) është e nevojshme të dorëzon daklarata të noterizuara nga drejtuesi i transmetimit, udhëheqësit (menazherit) të Shoqërisë për tregti dhe shërbime (SHTSH) KISS&MENADA SHPK Tetovë, i cili është themelues/pronar i vetëm i SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJ Tetovë, si dhe deklarata nga të tre themeluesit/pronarët e SHTSH KISS&MENADA SHPK Tetovë, ku detyrimisht duhet të ceket se radiodifuzeri SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJ Tetovë ndërprehen me transmetim të programit televiziv, si dhe datën e ndërprerjes (nga 19.11.2023).

Më datë 17.11.2023 në mënyrë elektronike, në adresën zyrtare të postës elektronike e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë nga SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJ Tetovë, janë dëruar deklaratat (e noterizuara), nr.ynë ark.08-3795/2 datë 17.11.2023 nga Drejtuesi i transmetimit, UZP nr.14145/2023 datë 17.11.2023, drejtuesit të SHTSH KISS&MENADA SHPK Tetovë, UZP nr.14146/2023 datë 17.11.2023, si dhe tre daklaratat nga themeluesit/pronarët e SHTSH KISS&MENADA SHPK Tetovë, UZP nr.972/2023, UZP nr.14149/2023 dhe UZP nr.14148/2023 të gjitha nga 17.11.2023, me të cilën personat e autorizuar deklarojnë se SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJ Tetovë nga 19.11.2023 ndërprehen me transmetim të programit televiziv. Transmetuesi në fjalë nuk ka borxh ndaj Agjencisë.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim në radio dhe televizion ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratën me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programeve në radio dhe televizion. Për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion në bazë ligjore Këshilli nuk sjell vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi 2).

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lart, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe neni 2 të LSHMAAV, si dhe deklaratat me shkrim të lartpërmendura nga personat e autorizuar dhe të noterizuara, janë plotësuar kushtet ligjore për fshirjen e transmetuesit të SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJ tetovë nga regjistri i radiodifuzerëve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, deklaratat (e noterizuara), nr.ynë ark.08-3795/2 datë 17.11.2023 nga drejtuesi i transmetuesit UZP nr.14145/2023, Drejtuesit të SHTSH KISS&MENADA SHPK Tetovë UZP nr.14146/2023 dhe nga themeluesit/pronarët e SHTSH KISS&MENADA SHPK Tetovë UZP nr.972/2023, UZP nr.14149/2023, UZP nr.14148/2023 të gjitha nga 17.11.2023, dhe në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele me nr.ark.01-3732/1 datë 29.7.2019 dhe konkluzionin me nr.ark.02-4325/11 datë 23.11.2023, është sjellë vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.